



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 222/25 Dt. 03.04.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Sevil Kazaz-anëtare e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Sevil Kazaz-anëtare e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, bazuar në ftesën zyrtare të kryetarit të Komunës Avcar të Republikës së Turqisë, drejtuar Komunës së Prizrenit me qëllim të pjesëmarrjes së një delegacioni zyrtar të Komunës së Prizrenit në Samitin Global për Ndërtimin e të Ardhmes së Qëndrueshme për Gratë dhe Rininë, që do të mbahet nga data 07 prill 2025 deri me 11 prill 2025.
2. Në këtë Samit, të cekur si në pikën 1 të këtij Vendimi do të marrin pjesë: Sevil Kazaz, Mimoza Bushrani, Drita Qenaj, Shukrije Berisha dhe Naxhije Memaj, anëtare të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, lejohet pagesa e shpenzimeve të udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dhe të mëditjeve.
3. Ky Samit organizohet në bashkëpunim me Institutin Amerikan për Diplomaci dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komunën Avcar.
4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës-pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
5. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurave,
 - Arkivës së Kryetarit.

